

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-24-10894-1-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me kontejner për mbeturina**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj:	<b>SEYKOS SH.P.K</b>
Adresa e plotë, vendi dhe kodi postar:	<b>RR. Ali Vitia ob-office 6.1, 10000 Prishtinë</b>
Numri Telefonit:	<b>049 135 760</b>
Numri i Faks-it:	<b>NA</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj:	<b>Shpejtim Kuçi</b>
Adresa elektronike:	<b><a href="mailto:seykos_ks@yahoo.com">seykos_ks@yahoo.com</a></b>
Data e parashtrimit të kërkesës:	<b>13.02.2025</b>
Nënshkrimi dhe vula:	

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me **PROKURË**. Shëno të dhënat si në vijim: **NA**

Emri i avokatit	
Adresa e plotë	
Numri i Telefonit	
Numri i faks-it	
Adresa elektronike	
Data e parashtrimit të ankesës	
Nënshkrimi dhe vula	

#### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- B05 Njoftim për Kontratë: 17.10.2024
- B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 25.11.2024
- Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje: 04.12.2024 14:00
- Kriteret e dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët
- Njoftimi mbi vendimin e AK 087.Vendimi B58\_001: 24.01.2025
- Kërkesa për rishqyrtim: 29.01.2025
- Vendimi i kërkesës për rishqyrtim – Refuzimi : 03.02.2025

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

#### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Po, me datë 29 Janar 2025, ne SEYKOS Shpk, si OE me interes dhe pjesëmarrës për këtë aktivitet të prokurimit, pas pranimi të njoftimit mbi vendimin e AK-ës, konform LPP-ës dhe në afat të rregullt kohorë kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim, të cilën AK me datë 03.Shkurt.2025, e ka refuzuar si të pa bazuar!

#### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1

Neni 6

Neni 7

Neni 27

Neni 59

Neni 60

Neni 69

Neni 70

Neni 72

RRPP 001.2022

Neni 25 - Kriteret e përzgjedhjes

Neni 27 - Kriteret e Dhënies së Kontratës

Neni 38, sqarimet e ofertës

Neni 10 nga UDHËZUESI Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një jobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

#### 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

## 1 KRONOLOGJIA

1.1. Autoriteti Kontraktues, në këtë rast KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, me datë 17.10.2024 ka iniciuar tenderin me titull: Furnizim me kontenjer për mbeturina, Numri i prokurimit: 622-24-10894-1-1-1., me ç'rast ne si OE te interesuar kemi marr pjese dhe kemi dorëzuar ofertën tonë më të mirë brenda afateve kohore të parashikuara me Njoftimin për Kontrate dhe njëherit oferta e jonë ka qenë më e lira për nga çmimi total i ofertës.

Prova 1: Njoftimi për Kontratë

Prova 2: Procesverbali i hapjes së tenderëve

1.2. Me datë 24.01.2025, kemi pranuar Letrën Standarde B58 njoftimin mbi vendimin e AK, ku kemi vërejtur se AK ka eliminuar pa të drejtë kompaninë tonë si të pa përgjegjshme dhe në vendim të kësaj letër, AK (citoj) “**anulon** aktivitetin e prokurimit: **për arsye se nuk kemi OE te përgjegjshëm.**” mbyllet citati.

Prova 3: Njoftimi mbi vendimin e AK dhe

Letrat Standarde për tenderuesin e eliminuar

1.3. Ne si OE dhe me interes, duke e parë se AK, nuk ka vepruar drejtë dhe në përputhje me LPP dhe RRPP, me datë 29.01.2025, kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim, të cilën AK me datë 03.02.2025, e ka **refuzuar** si të pa bazuar pa e shtjelluar fare por vetëm duke i vendosur arsyet mbi të cilat ka eliminuar kompaninë tonë!!!.

Prova 4: Kërkesa për Rishqyrtim 29.01.2025 dhe

Prova 5: Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim

---

### Faktet dhe Argumentet:

Të nderuar përfaqësues të OSHP-ës

Konsiderojmë se AK me eliminimin e ofertës tonë sipas arsytimit të dhënë (citoj),

[Ju jeni diskualifikuar ] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye : **Ju mungojnë :**  
**Kërkesa 8: Certifikate qe kontenieret nga plastika jane te testuar nga ndonje institucion I licensuar per certifikime**

**Deshmia 8: OE duhet te deshmoj me**

**-Certifikate se kontenieret nga plastika jane te testuar ne akordim me**

**- EN 840-1 2020,**

**-EN 840-5 2020,**

**-EN 840-6 2020,**

**-RAL-GZ 951 1 06.13 dhe**

**-AFPS GS 2019 01 PAK – vlen per POZ.**

**- 2.Certifikata duhet te jete e leshuar ne emer te prodhuesit.**

**Ju mungon:**

**- certifikata -TS EN 840- 1, TS EN 840-5, TS-EN 840-60 , EN1501 ,EN 840-2 , TS EN 10204;2007 DHE TS EN ISO 9606-1**

**Autorizimet , katalogjet , Certifikatat nuk janë sipas aneksit 1 Specifikimet e detyrueshme te kërkuara sipas dosjes se tenderit.**

drejtpërdrejtë ka vepruar në kundërshtim me Dosjen e tenderit, LPP-ën, dhe Rregullave për Prokurim Publik, pasi që, ne si OE kemi përmbushur me përpikëri kërkesat e Njoftimit për kontratë dhe DT te paracaktuar ne FTD-ë dhe Aneksin-1, gjithashtu kemi dorëzuar edhe deklaratën e përmbushjes së specifikave teknike përmes të cilës jemi zotuar se bashku me prodhuesin qe e përfaqësojmë se mallrat e ofruara përmbushin specifikat e Aneksit-1.

Të nderuar përfaqësues të OSHP-ës, sa i përket pikës referuar si më poshtë;

**Deshmia 8: OE duhet te deshmoj me**

**-Certifikate se kontenieret nga plastika jane te testuar ne akordim me**

**- EN 840-1 2020,**

**-EN 840-5 2020,**

**-EN 840-6 2020,**

**-RAL-GZ 951 1 06.13 dhe**

**-AFPS GS 2019 01 PAK – vlen per POZ.**

**- 2.Certifikata duhet te jete e leshuar ne emer te prodhuesit.**

#### **1. EN840 + RAL GZ 951/1**

Ne ju informojmë se Certifikata e dorëzuar me ofertën tonë është në emër të prodhuesit dhe është lëshuar nga laborator i akredituar për EN 840 (faqe 195/216) dhe RAL GZ 951/1 (faqe 98/216).

**2. AfPS FS 2019 01 PAK – është përmbajtja e 15 hidrokarbureve aromatike policiklike (PAH) në plastikë dhe gomë dhe produkte të bëra prej tyre (p.sh. lodra, enë gatimi), sipas AfPS GS 2019:01 PAK nëse nivelet e PAH janë mjaftueshëm të ulëta, produkti mund të marrë një markë GS (një etiketë vullnetare gjermane e sigurisë së produktit). Prodhuesi me produktet e të cilit ne kemi ofertuar, është i graduar me markën GS, e cila është e mjaftueshme për këtë standard, dhe për këtë ne i kemi dorëzuar dëshmitë ne ofertën tone, por AK nuk i ka marre për baze, apo thënë me drejt i ka neglizhuar komplet.**

**Geprüft nach** *Tested according to:*

EN 840-1:2020

EN 840-5:2020

EN 840-6:2020

RAL-GZ 951/1/08.23

AfPS GS 2019:01 PAK

**Prova 6: Bashkangjitur gjeni certifikatën + dëshmi akreditimin e laboratorit**

Ne me dorëzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, i kemi rikujtuar AK se, konform Nenit 7 të LPP-ës, obligoheni që t'i trajtoni OE në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe se është i obliguat të veprojnë në mënyrë transparente.

Gjithashtu, se AK obligohet të mos ekzekutoj asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të OE ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

Për më tepër AK posaçërisht i ndalohej që të përcaktojë nevojat e veta, të specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi të ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik

Prandaj, të nderuar përfaqësues të OSHP-ës, pretendimi i AK ku thotë se (citoj)

**Ju mungon:**

- certifikata -TS EN 840- 1, TS EN 840-5, TS-EN 840-60 , EN1501 ,EN 840-2 , TS EN 10204;2007 DHE TS EN ISO 9606-1

Nuk është i drejtë e as i sakte, sepse ne si OE me interes për këtë dëshmi kem dorëzuar certifikata sipas standardeve evropiane, prandaj pretendimi i AK se ne nuk e kemi dorëzuar këtë lloj certifikate sepse certifikata e jonë nuk e ka termin “TS” para EN 840 standardit, është plotësisht jo profesional dhe për me keq edhe diskriminues dhe i ndalur me ligj.

Për sqarimin e OSHP-ës shenja “TS EN” është Standard Turk (Turkish Standard) që lëshohet nga (TSE - Instituti Turk i Standardeve), prandaj, nëse AK kërkon që për të qenë certifikatat të pranueshme duhet të kenë me pa tjetër shenjen “TS” para EN i bie që AK të kërkojnë produktin e prodhuar vetëm nga kompani TURKE dhe të licencuara vetëm nga Instituti Turkish Standart, kërkesë kjo që bie në kundërshtim me LPP-ën neni 28 paragrafi 4.

Prandaj, për informimin tuaj, bazuar edhe nga dëshmitë ne ofertën tone, ju mund të vërtetoni se produkti i ofruar nga ne është certifikuar nga një Institut Gjerman, prandaj nuk mund të klasifikohet si i pa pranueshëm nga ana e AK.

Sepse, mbështetur në LPP neni 28, paragrafi 28.4 dhe 28.5, thuhet;

28.4. AK do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratim teknik Evropian, (iv) një specifikim të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim.

28.5. Nëse një standard i aplikueshëm, specifikim, ose miratim që kërkohet sipas paragrafit 4. nuk ekziston, ose nëse përdorimi i tij kërkon që autoriteti kontraktues të përdorë materiale ose produkte që nuk janë të përshtatshme me pajisjet që tashmë janë në dispozicion ose nëse përdorimi i tyre do të shkaktojë shpenzime të tepruara dhe të panevojshme, autoriteti i tillë kontraktues mund të përgatisë specifikacionin e tillë teknik duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës ose (ii) një miratim teknik të Kosovës.

Prandaj, bazuar në këtë shpjegim, standardi TS as që duhet të merret parasysh, e atë me pak si bazë për eliminimin e një oferte e cila i plotëson standardet e BE-se.

Link për standardin turk TS;

<https://intweb.tse.org.tr/standard/standard/Standard.aspx?081118051115108051104119110104055047105102120088111043113104073090082053047110065057085108075077>

<https://intweb.tse.org.tr/standard/standard/Kapak.aspx?081118051115108051104119110104055047105102120088111043113104073090082053047110065057085108075077>

**3.** Lidhur me kërkesën e AK të paraqitur në specifikimin teknik - **standardin EN 1501**, ne ju njoftojmë, por edhe ju apo eksperti i lëndës mund të e vërtetoj me një kërkim të thjeshtë në internet, se ky standard përshkruan dhe përcakton kërkesat e sigurisë për RCV-të (automjetet e grumbullimit të mbeturinave), apo thëne me sakte për pjesën e ngarkuara pas, duke përjashtuar ndërfaqen e derës së pasme/shkarkimit me pajisjen(et) ngritëse.

Pra ky standard nuk ka të bëjë fare me modelin e kontejnerit të kërkuar, cilësinë apo diçka të ngjashme që lidhet me kontejner, apo mënyrës së prodhimit, pasi që ky standard është vetëm për mekanizimin ngarkues dhe shkarkues të mbeturinave që vendoset në kamion.

Kompania prodhuese të cilën e përfaqësojmë ne në këtë tender dhe produktet e të cilit ne i kemi ofruar janë të testuar sipas EN 840, dhe kjo është në përputhje me të gjitha kërkesat e Aneksit-1 të kësaj DT-je.

[https://standards.iteh.ai/catalog/standards/cen/f4802692-8a2e-4e79-916d-8c2071fa6b90/en-1501-1-2021?srsId=AfmBOorFs0yw9B8z-z4sCnpHGOg9tJeUH9SBuMhCX43M\\_X3bIYvYVr9c](https://standards.iteh.ai/catalog/standards/cen/f4802692-8a2e-4e79-916d-8c2071fa6b90/en-1501-1-2021?srsId=AfmBOorFs0yw9B8z-z4sCnpHGOg9tJeUH9SBuMhCX43M_X3bIYvYVr9c)

**4.** AK ka përmendur se ne nuk kemi dorëzuar Certifikatën **EN 840-2**. Të nderuar zyrtar dhe përfaqësues të OSHP-ës, **standardi EN-840-2** përcakton standardet për kontejnerët e lëvizshëm të mbeturinave të plastikës dhe riciklimit, respektivisht kontejnerë me 4 rrota me kapacitet prej 660L deri në 1,100L me kapak të sheshtë (rrafshtë), pra ky standard fare nuk është i aplikueshëm për kërkesat e këtij tenderi, sepse AK në këtë tender ka kërkuar kontejner të plastikës prej 120L me 2 rrotë, kontejner Metalik 1.1 m<sup>3</sup> me 4 rrotë. Prandaj, AK para se të merrte këtë vendim, ashtu si e obligon LPP neni 72 dhe Rregullorja neni 38, do të duhej të kërkonte sqarime, dhe nëse AK do të kërkonte kontejner të plastikës me 4 rrotë, ne me siguri se do të dorëzonim edhe këtë standard sepse kompania prodhuese të cilën ne e përfaqësojmë e posedon edhe këtë standard.

#### **Prova 7: Certifikata e Standardit EN 840-2**

Prandaj bazuar në LPP neni 59 paragrafi 2 dhe neni 72 AK do të duhej se paku të kërkonte sqarime për këtë certifikatë para se të merrte çfarëdo vendimi.

**5.** Të nderuar zyrtar të OSHP, sa i përket standardit **EN ISO 9606-1** për të cilin AK ne vendimin për eliminim e specifikon se ne si OE ofertues nuk e kemi dorëzuar me ofertën tonë, ne se pari duam të ju sqarojmë se ky standard paraqet/specifikon kërkesat për testimin e kualifikimit të saldatorëve për saldimin me shkrirje të çeliqueve, pavarësisht kësaj kërkesë e cila nuk ka të bëjë fare me kualitetin apo ndonjë standard për kontejner, ne ju informojmë se ky standard përmbushet me standardin **EN 840**, standardin e ofruar nga ana e jonë sipas kërkesës në FTD.



Për referencë të OSHP-ës, ju mund të vëreni se edhe ky dokument është lëshuar nga kompania e njëjtë certifikuese me EN 840.

Për më tepër AK ka përcaktuar në Specifikimin Teknik që edhe ky standard të ofrohet nga Institucioni Turk i Standardizimit “TS EN”, çka nënkupton se për AK, certifikatat e standardeve të lëshuara në vendet e BE-se nuk mund të klasifikohen si të papranueshme. Sepse kjo bie në kundërshtim me LPP neni 28 paragrafi 28.4.

#### ***Prova 8: Certifikata sipas EN Standardit.***

Prandaj, të nderuar zyrtar dhe përfaqësues të OSHP-ës,

Konform Nenit 1 të LPP-ës vërejmë se AK nuk ka vepruar drejtë për të siguruar mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, nuk ka ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike, sepse ne si OE ***për të njëjtin Aktivitet të Prokurimit, 2 herë jemi renditur si OE më i lirë për nga çmimi total i tenderit***, ndërkaj AK na ka eliminuar drejtpërdrejtë pa marrë fare mundin që të kërkoj sqarime shtesë ashtu si e obligon LPP neni 72 dhe Rregullorja 01/2022 neni 38.

Konform Nenit 59 – Pika 1 Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, ku të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës, këtë pikë të këtij neni konsiderojmë se Komisioni vlerësues nuk e ka marrë fare për bazë, sepse, ky komision, sipas pikës 2 të po këtij neni, do të duhej që me shkrim të kërkonte nga ana e jonë që të siguronim një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e këtij tenderi, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve, dhe të mos vepronte direkt në eliminim të kompanisë tonë sepse LPP e kërkon ndryshe të veprohet.

Sa i përket Nenit 60 të LPP-ës, AK nuk ka vepruar përkitazi me këtë nen kur ka përcaktuar kriterin për tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, sepse oferta e jonë përveç se është e përgjegjshme, e njëjta është edhe më e lirë sipas kriterit të AK, dhe në këtë rast, AK nuk e ka respektuar kriterin e vendosur.

Sipas Nenit 69 të LPP-ës, ne si OE kemi dëshmuar aftësitë teknike dhe profesionale nga ana e jonë si OE i përgjegjshëm në të gjitha kërkesat e Njoftimit për kontratë dhe DT, ndërkaj AK nuk ka vepruar fare sipas pikës 2 të këtij neni, por ka eliminuar direkt kompaninë tonë.

Duke u ndërlidhur me Nenin 70 të LPP-ës, AK nuk e ka marrë për bazë këtë nen, sepse ka kërkuar që produkti të jetë i certifikuar nga një Institut Turk i Certifikimit, ndërkaj duke u bazuar edhe në nenin 28 paragrafi 4, neni specifikon qartazi se AK do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilindo organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së, dhe certifikatat tona janë të lëshuara nga TÜV Rheinland LGA Products GmbH, ndërsa AK i ka refuzuar si të pa mjaftueshme.

Konform Nenit 72 që lidhet me nenin 59 paragrafi 2 të LPP-ës dhe Neni 38 i Rregullores nr. 001/2022, Autoriteti Kontraktues do të duhej që paraprakisht të kërkonte dokumente dhe informacione shtesë pranë kompanisë tonë para se të ndërmarr vendimin për eliminim të kompanisë tonë dhe anulimin e këtij aktiviteti, dhe në rast se ne si OE nuk do të

përgjigjeshim brenda afateve kohore të parapara me LPP atëherë me të drejte do të mund të na eliminonte si OE i pa përgjegjshëm.

Sepse ligji e obligon një AK që konform LPP neni 72, po citoj:

1. *Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.*
2. *Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.*
3. *Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.*

Dhe Rregullores nr. 001/2022 neni 38, paragrafi 38.3 dhe 38.5, po citoj;

- *38.3. Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë;*
- *38.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE.*

Si dëshmi, se bashku me këtë ANKESË ne ju konfirmojmë se dokumentet e dorëzuara së bashku me dosjen e tenderit për të cilat AK ka cituar se ne jemi eliminuar, ekzistenca e të cilave është e fiksuar para datës së dorëzimit të tenderëve.

#### **6. Duke u ndërlidh me pretendimin e AK se (citoj)**

*Autorizimet , katalogjet , Certifikatat nuk janë sipas aneksit 1 Specifikimet e detyrueshme të kërkuara sipas dosjes së tenderit.*

Ne si OE kemi vlerësuar se AK ka përmendur vetëm si pretekste pa dhënë asnjë vlerësim se cilat kërkesa të AK nuk përmbushin këto dokumente, sepse si të tilla ne i kemi konsideruar dhe vlerësuar se këto dokumente janë në përputhje me kërkesat e DT dhe të njëjtat janë dorëzuar së bashku me dokumentet tjera të tenderit brenda afatit të përcaktuar për dorëzimin e DT.

**Prandaj, të nderuar zyrtar dhe përfaqësues të OSHP-ës, bazuar në të gjitha këto që u ceken më lartë ne kërkojmë nga Organi i juaj Shqyrtues i Prokurimit që të nxjerr:**



## VENDIM

- 1. APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE SEYKOS shpk,**
- 2. ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK i datës 24.01.2025, dhe lënda e këtij aktiviteti të kthehet në RIVLERËSIM,**

### 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

### 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*